



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

I dedikuar për cilësi, standarde dhe suksese
Dedicated for quality, standards and excellences
Posvecen kvalitetu, standardima i uspjehu

Rezultatet përmbledhëse të vlerësimit nga pyetësi **"Studenti Mësimdhënësin"**

Semestri dimëror, 2024/25

1. Qëllimi i vlerësimit

Realizimi i këtij vlerësimi ka për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, në mënyrë që të arrijmë të identifikojmë sfidat e mundshme në lidhje me përmbushjen e objektivave mësimore, dhe të bëjmë përpjekje për t'i larguar ato.

2. Procesi i vlerësimit

Ashtu siç është e paraparë në kalendarin e aktiviteteve, në fund të secilit semestër, studentët plotësojnë pyetësin "Studenti – Mësimdhënësin" për të vlerësuar lëndën dhe profesorin e lëndës. Procesi i vlerësimit në të pesë njësitë akademike, për semestrin dimëror 2024/2025, ka filluar me datë 14 janar dhe ka zgjatë deri me 23 janar. Vlerësimi është bërë për profesorët dhe asistentët e secilës lëndë të ligjruar në semestrin dimëror të vitit akademik 2024/25. Gjatë kësaj periudhe janë vlerësuar 152 staf akademik, 80 staf të rregullt dhe 72 staf të angazhuar.

Këtë semestër, plotësimi i pyetësorit është realizuar përmes sistemit SEVC, gjatë periudhës së paraqitjeve të provimeve, për profesorët dhe asistentët e të pesë njësive akademike. Para fillimit të procesit të vlerësimit, i gjithë stafi akademik dhe studentët janë njoftuar për fillimin e procesit. Studentët janë njoftuar edhe me rregullat e përgjithshme të këtij procesi, duke i garantuar ata se pyetësorët janë anonim dhe se ata mund të shprehin lirshëm atë që mendojnë për secilin mësimdhënës dhe lëndë të vlerësuar. Pas përfundimit të periudhës vlerësuese, Koordinatorët/Zyrtarët e cilësisë dhe Zyra qendrore kanë përpunuar të dhënat nga ky proces, të cilat janë analizuar nga Komisionet për sigurim të cilësisë dhe vlerësim në nivel të njësive akademike dhe Këshilli për menaxhim të cilësisë dhe vlerësim në nivel qendror. Komisionet dhe Këshilli, pas analizimit të procesit, duke u bazuar në gjetjet e vlerësimit kanë dhënë rekomandime për përmirësim.

3. Rezultatet e vlerësimit

1. Studentët deklarojnë se kanë marrë literaturën nga mësime dhënësi, ku 92% e tyre janë përgjigjur me "Po", ndërsa vetëm 8% me "Jo". Këto rezultate ofrojnë një pasqyrë të ndarjes së opinionit mes studentëve. Pjesa më e madhe, 92%, konfirmon se ka pranuar literaturën e lëndës nga mësime dhënësi, ndërsa 8% e studentëve raportojnë se nuk e kanë marrë atë (figura 1).




Figura 1

2. Studentët kanë deklaruar se mënyrat më të zakonshme për pranim të literaturës janë përmes SMS-it dhe e-mailit, ku 48% kanë pohuar se e marrin literaturën përmes SMS-it, ndërsa 34% përmes e-mailit. Po ashtu, 10% kanë deklaruar se literaturën mund ta gjejnë në bibliotekë, ndërsa 8% nuk e kanë pranuar në asnjë formë. Nga kjo mund të konkludohet se, përveç SMS-it dhe e-mailit, është e nevojshme që biblioteka të pasurohet me literaturën e propozuar të programeve të studimit (figura 2).




Figura 2

3. Rezultatet tregojnë se shumica e studentëve e kanë kuptuar mirë literaturën e lëndëve, ku 88% e tyre deklaruan se materialet ishin të kuptueshme. Kjo është një tregues pozitiv që mësime të mësimdhënësve kanë arritur t'i prezantojnë materialet në një mënyrë që shumica e studentëve i kanë kuptuar. Nga ana tjetër, 6% e studentëve u përgjigjën me "jo" lidhur me kuptueshmërinë e literaturës, duke treguar se një përqindje e vogël e tyre ndjeu se materialet nuk ishin të qarta. Ndërkohë, 6% e studentëve mbetën neutral (figura 3).




Figura 3

4. Sipas rezultateve, 81% e studentëve konfirmojnë se kanë marrë informacion të qartë nga mësime të mësimdhënësve lidhur me mënyrën e vlerësimit, 15% janë informuar pjesërisht, ndërsa 4% nuk kanë marrë fare informacion. Këto të dhëna tregojnë se shumica e mësime të mësimdhënësve e prezantojnë qartë procesin e vlerësimit që në fillim të çdo semestri (figura 4).




Figura 4

5. 78% të studentëve pohojnë se ligjëratat e shpjeguara nga mësime dhënësit kanë qenë shumë të qarta, dhe kjo përqindje e lartë tregon se shumica më e madhe e studentëve janë të kënaqur me shpjegimet e ofruara nga mësime dhënësit. 17% e studentëve pohojnë se kanë qenë mesatarisht të qarta, dhe kjo tregon se ka një grup të vogël studentësh që kanë ndier se ka disa sfida të vogla në kuptimin e materialit nga ligjëratat. Ndërsa, për 5% të studentëve thonë se nuk kanë qenë të qarta ligjëratat e shpjeguara nga mësime dhënësit (figura 5).



Figura 5

6. Analiza e përqindjeve të përgjigjeve tregon se shumica e studentëve kanë pasur përvoja pozitive në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve mësimore plotësuese. Përqindja më e madhe e studentëve, 73% pohojnë se janë zhvilluar shumë aktivitete mësimore plotësuese. Kjo tregon se shkalla e përfshirjes së aktiviteteve të ndryshme si ushtrime, punë praktike, laboratorë, etj, ka qenë e lartë. Një përqindje më e vogël e studentëve 20% thonë se aktivitetet mësimore plotësuese janë zhvilluar mesatarisht. Kjo mund të tregojë se ndërhyrja e ndonjë aktiviteti shtesë ka ndodhur, por nuk është ndjekur në masën më të lartë. Përqindja më e ulët 7% e studentëve raportojnë se nuk janë zhvilluar fare aktivitete mësimore plotësuese (figura 6).




Figura 6

7. 81% e studentëve kanë vlerësuar që mësime dhënësit po ndjekin syllabusin dhe po ligjërojnë temat e parapara. 15% e studentëve kanë vlerësuar që mësime dhënësit po i ligjërojnë temat mesatarisht sipas syllabusit. Ndërsa, 4% janë përgjigjur me "jo", dhe kjo përqindje e ulët tregon se një numër shumë i vogël i studentëve vlerësojnë që mësime dhënësit nuk po ndjekin syllabusin (figura 7).



Figura 7

8. A ka mbajtur mësime dhënësi konsultime gjatë semestrit, 83% janë përgjigjur me "po" dhe kjo përqindje tregon se shumica e studentëve kanë mbajtur konsultime gjatë semestrit nga mësime dhënësit. 8% janë përgjigjur me "jo", edhe pse përqindja është relativisht e ulët, kjo tregon se ka një grup të vogël studentësh që nuk kanë pasur mundësi për të marrë konsultime gjatë semestrit. 9% janë përgjigjur me "nuk e di" dhe kjo përqindje tregon se një grup i vogël studentësh nuk janë të sigurtë nëse mësime dhënësit kanë ofruar konsultime gjatë semestrit (figura 8).




Figura 8

9. Pjesa më e madhe e studentëve, rreth 79% janë përgjigjur se mësime dhënësit kanë qenë shumë të gatshëm për sqarime dhe shpjegime shtesë gjatë orarit të konsultimeve. 16% janë përgjigjur me "mesatarisht i gatshëm", kjo përqindje tregon që një pjesë më e vogël e studentëve e vlerësojnë gatishmërinë e mësime dhënësit për sqarime dhe shpjegime shtesë si mesatare. Ndërsa, 5% të studentëve janë përgjigjur me "jo, nuk ka qenë i gatshëm" (figura 9).




Figura 9

10. 79% të studentëve janë përgjigjur me "po, është shumë bashkëveprues", dhe kjo përqindje e lartë tregon se shumica e studentëve vlerësojnë që mësime dhënësit janë shumë bashkëveprues gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. 17% janë përgjigjur me "është mesatarisht bashkëveprues", kjo përqindje tregon që një pjesë më e vogël e studentëve e vlerësojnë mësime dhënësit si mesatarisht bashkëveprues gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. 4% janë përgjigjur me "jo, nuk është bashkëveprues", pra një grup shumë i vogël i studentëve ka vlerësuar mësime dhënësit si jo bashkëveprues gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve (figura 10).




Figura 10

11. Se a ka ofruar mësimdhënësi shembuj praktik nga ajo çka është shpjeguar në teori, studentët janë përgjigjur si në vijim: 78% janë përgjigjur me "po", dhe kjo përqindje tregon se shumica e studentëve kanë vlerësuar që mësimdhënësi ofron shembuj praktik për të ilustruar materialet e shpjeguara në teori. 17% janë përgjigjur me "mesatarisht", kjo përqindje tregon që një pjesë e vogël e studentëve vlerësojnë mësimdhënësin si mesatarisht efikas për të ofruar shembuj praktik për të ilustruar teorinë. 5% janë përgjigjur me "jo" dhe kjo përqindje e ulët tregon se një grup shumë i vogël i studentëve nuk ka vlerësuar që mësimdhënësi ofron shembuj praktik nga materialet e shpjeguara në teori (figura 11).




Figura 11

12. 76% të studentëve kanë vlerësuar që mënyra e ligjërimit e mësimdhënësit ka ndikuar shumë në nxitjen e interesit për ligjëratat. 18% janë përgjigjur me "mesatarisht ka nxitur interesim", kjo përqindje tregon që një pjesë më e vogël e studentëve vlerësojnë mësimdhënësin si mesatarisht efikas për të nxitur interesin për ligjëratat. 6% janë përgjigjur me "jo, nuk ka nxitur interesim", kjo përqindje tregon se një grup i vogël i studentëve ka vlerësuar që mënyra e ligjërimit e mësimdhënësit nuk ka ndikuar në nxitjen e interesit për ligjëratat (figura 12).




Figura 12

Rekomandimet për përmirësim, të propozuara nga Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim:

1. E gjithë literatura e propozuar në syllabus të jetë e qasshme në disa forma: fizike në bibliotekë, dhe digjitale përmes emailit ose platformës SMU.
2. Mësimdhënësit të prezantojnë qartë metodologjinë e vlerësimit që në javën e parë të ligjëratës.
3. Mësimdhënësit të përdorin më shumë shembuj konkretë, mjete vizuale dhe teknika të mësimdhënies aktive për të rritur mësimnxënien.
4. Konsultimet me studentë të publikohen që në fillim të semestrit.
5. Të inkurajohen diskutime dhe aktivitete interaktive gjatë ligjëratave për të rritur përfshirjen e studentëve.
6. Trajnime për mësimdhënësit mbi teknika për të bërë ligjëratat më dinamike dhe tërheqëse.